VENDIM
Nr. 90, datë 28.4.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SALILLARI ENERGY TRADE" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 579 prot., datë 19.4.2022, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Salillari Energy Trade' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 470 prot., datë 6.4.2022, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b" dhe "d", plotësuar;

- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germat: "a", "c", "d", "f", "h" dhe "i", plotësuar;

- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet sipas kësaj kërkese të rregullores;

- germa "e" (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse...). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e organizimit të saj;

Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera)).

Shoqëria ka paraqitur dokumentacion vërtetues në lidhje me mbështetjen financiare nga ana e shoqërisë mëmë, por nuk janë specifikuar vlerat monetare me të cilat shoqëria mëmë do të financojë

shoqërinë "Salillari Energy Trade" sh.p.k. në funksion të realizimit të veprimtarisë dhe aktivitetit të saj;

- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa "b" (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj)).

Shoqëria duhet të përcaktojë vlerën që do të vendosë në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike;

- germa "e" (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët, për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen përkatëse për të përdorur sistemin IT të shoqërisë mëmë, duke specifikuar sistemin bazuar te veprimtaria për të cilën kërkon të licencohet shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k;

- germa "g" (dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve). Shoqëria duhet të depozitojë sa kërkon kjo pikë e rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Salillari Energy Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti